

INFORMAZIONI SUL PERCORSO DI INTERRUZIONE VOLONTARIA DI GRAVIDANZA-ALBANESE

Informacione mbi rrugën e ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë

Që prej vitit 1978, sipas Ligjit 194, çdo grua ka mundësinë të kërkojë ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë (NVSH) brenda 90 ditëve të para të barrës për arsye shëndetësore, familjare, sociale, ekonomike. NVSH kryhet brenda institucioneve shëndetësore shtetërore, kërkesa për ndërprerjen e shtatzënisë duhet të nënshkruhet nga e interesuara dhe nga mjeku i cili kryen konsultën dhe vizitën mjekësore. Procedura është falas.

Pas 90 ditësh të shtatzënisë, vlerësimi për një ndërprerje të mundshme të shtatzënisë bëhet në raste të rënda të gjendjes shëndetësore të nënës ose të embrionit, gjithmonë nga ana e një ekipi mjekësor. Në rast të një kërkesë për NVSH nga të miturit, kërkohet autorizimi i të dy prindërve që kanë kujdestarinë prindërore, në rast mungese të autorizimit prindëror, situata i paraqitet gjykatësit përkatës përmes një raporti të Shërbimeve.

Cila është rruga që duhet ndjekur për Ndërprerjen e Vullnetshme të Shtatzënisë (nvsh)?

Mund t'i drejtohesh Konsultores, mundësisht në zonën tënde të vendbanimit, ku do të gjesh mirëpritje, informacione mbi rrugën që duhet ndjekur, këshillim (counselling) si dhe t'u lihet nje takim me Gjinekologun i cili do t'ju japë të gjitha informacionet e nevojshme mbi metodat e kryerjes së NVSH dhe do të lëshojë një dokument që tregon jo vetëm situatën tuaj të shtatzënisë por dhe gatishmërinë tuaj për ta ndërprerë atë.

Nëse je midis 14 dhe 24 vjeç, drejtohu Konsultores për të Rinjtë, një qendër kushtuar kësaj grup moshe e pranishme në të gjitha Zonat.

Konsultorja garanton gjithashtu bashkebisedime dhe këshillim për të hequr shkaqe të mundëshme që çojnë në vendimin e ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë si dhe ofron ndihmë psikologjike dhe shoqërore, sipas kërkesës, jep informacione mbi shoqatat vullnetare.

Gjithashtu sigurohet lidhja me repartet spitalore dhe klinikat referuse për kryerjen e NVSH.

Duke pasur parasysh afatet kohore për kryerjen e NVSH dhe zgjedhjen e metodës, është e rëndësishme të mos vonohet për t'u drejtuar Konsultores për të pasur kohën e nevojshme për të marrë vendimin me qetësi dhe mundësinë për të ndjekur dhe procedurën e NVSH farmakologjike.

Çfarë duhet të sjell për lëshimin e dokumentit/certifikatës?

- test shtatzënie nga laborator i kryer nëpërmjet analizave të urinës ose të gjakut që mat sasinë e Beta HCG (hormoni i shtatzënisë)
- një dokument i vlefshëm identifikimi
- për shtetasit italianë dhe të huaj të regjistruar në SSN (Shërbimin Shendetësor Nacional): kartën shendetësore të vlefshme
- për Shtetasit e Huaj të pa regjistruar në SSN (Shërbimin Shendetësor Nacional), që i përkasin Bashkimit Evropian ose Vendeve me të cilat janë lidhur Konventa: vlejnjë rregullat e përcaktuara në marrëveshjet reciproke
- për shtetasit jo-BE që nuk kanë vizë e leje qëndrimi të rregullt, pa burime ekonomike: dokumentin STP(I huaj perkohesisht i pranishem).

Jam e mitur dhe dua të ndërpres shtatzëninë.

Drejtohu Konsultores për të Rinjtë, mundësisht në zonën tënde, ku do të gjesh mirëpritje, ndihmë dhe mbështetje. Nëse je nën tetëmbëdhjetë vjeç për NVSH, kërkohet pëlqimi i të dy prindërve, nëse ata kanë autorizim prindëror të përbashkët, ose të prindit të vetëm që ka autoritet ekskluziv prindëror. Nëse tashmë keni biseduar me prindërit tuaj për këtë, mundeni të shkoni me ta në Konsultore në të kundërt operatorët e Konsultores do të ndihmojnë t'i përfshini dhe ata. Nëse nuk mundesh ose nuk dëshiron të flasësh me ta ekipi i Konsultores brenda shtatë ditësh do të përgatisë një relacion të përbashkët që punonjësi social do t'ia drejtoj gjyqtarit të tutelës i cili, pasi vlerëson çështjen, do të shprehë pëlqimin e tij. Mos harroni se në të gjitha këto procedura askush nuk autorizohet të kontaktojë prindërit e tu pa dijeninë tënde.

Kur mund të bëj ndërhyrjen e ndërprerjes së shtatzënisë?

Sipas ligjit, normalisht është e nevojshme të presësh shtatë ditë midis lëshimit të dokumentit dhe kryerjes së ndërprerjes të shtatzënisë. Sidoqoftë, një ndryshim i mendimit mund të bëhet në çdo kohë. Dokumenti mund të lëshohet përveçse nga mjeku i Konsultores edhe nga mjeku i familjes ose ai i besuar.

Gjatë këtyre 7 ditëve mund të shkosh në spitalin e referimit, ose në një tjetër të zgjedhur nga ty, në ditën kur qëndron hapur për NVSH për të programuar atë që është e nevojshme. Mjeku do të kryej vlerësimin klinik, do të japë të gjitha informacionet dhe sqarimet e nevojshme dhe do të marrë pëlqimin tënd. Do të bëhet dhe një këshillim mbi kontraktivët dhe bazuar në këtë, planifikohet dhe kontraktiv.

Në çdo kohë mund të kërkoni konsultë psikologjike dhe shoqërore.

Si mund të ndërpres shtatzëninë?

Shtatzënia mund të ndërpritet me dy metoda:

- abort kirurgjik
- abort farmakologjik

Ke të drejtë të zgjedhësh metodën që preferon nëse nuk ka kundër-udhëzime mjekësore për metodën e zgjedhur e nëse je brënda kohës së parashikuar.

Si kryhet aborti farmakologjik?

Mund të zgjedhësh rrugën farmakologjike nëse shtatzënia jote është më pak se 63 ditë (9 javë) nga cikli i fundit menstrual dhe nëse nuk ka kundër-udhëzime për përdorimin e ilaçeve të parashikuara. Është një proces që zhvillohet në nivel ambulatorial në dy faza. Në fazën e parë merret një ilaç (Mifepristone, i njohur më mirë si Ru486) që ndërpret shtatzëninë. Më pas, saktësisht pas 48 orësh, kalohet te ilaçi i dytë, i ngjashëm me prostaglandinat, që lehtëson shkëputjen dhe dëbimin e produktit të formuar.

Simptomat do të jenë të ngjashme me atë të një aborti spontan në fazat e para të shtatzënisë. Do të qëndrosh nën kontroll për disa orë dhe, para se të kthehesh në shtëpi, do t'u jepen të gjitha informacionet dhe kontaktet referuese të nevojshme. Mbas përreth dy javësh nga marrja e ilaçit të dytë është e nevojshme kryerja e një vizite mjekësore me kontroll ekografik për të verifikuar abortimin dhe nevojshmërinë për trajtime të mëtejshme.

Si kryhet aborti kirurgjik?

Ndërhyrja mjekësore kirurgjike përfshin qëndrimin një ditë në spital (day hospital). Hyet herët në mëngjes dhe dalja bëhet pasdite të së njëjtës ditë nëse nuk ka ndërlikime. Ndërhyrja, e kryer me anestezi, bëhet në sallën e operacionit. Përgjatë ndërhyrjes, nëse e kërkoni, mund t'u vendoset falas, si kontraktiv, sipiralja ose implanti nën lëkur.

Pas rreth 20 ditësh pas ndërhyrjes do të duhet të përsëritësh një test laboratorik të shtatzënisë.

A mund të ndërpres shtatzëninë pas muajit të tretë?

Ndërprerja e shtatzënisë pas 90 ditëve të para nga data e konceptimit është i mundur vetëm kur "shtatzënia ose lindja e fëmijës përbëjnë një rrezik serioz për jetën e gruas" ose, brenda kufijve të parashikuar nga neni 7 i Ligjit 194/78, kur konstatohen procese patologjike, përfshirë ato që kanë të bëjnë me anomali ose keqformime të rëndësishme të embrionit, "të cilat shkaktojnë një rrezik serioz për shëndetin fizik e mendor të gruas". Gjinekologu i qendrës shëndetësore ku kryhet NVSH, mund të bashkëpunoj me specialist të tjerë për dokumentat dhe certifikimin.

Çfarë duhet bërë pas ndërprerjes së vullnetshme të shtatzënisë?

Pas NVSH (ndërprejes së vullnetshme të shtatëzënisë) do të duhet të kryesh kontrollet që do të caktohen nga Gjinekologu.

Në Konsultore, përveç kontrollit gjinekologjik, mund të përfitosh këshillimin psikologjik dhe atë të ndihmës përkrahëse duke kontaktuar me Shërbimet. Për të ulur shkallën e rrezikshmërisë të shtatzënive të padëshiruara, është gjithashtu e rëndësishme të planifikosh dhe të fillosh menjëherë përdorimin e kontraktivëve që në dy vitet në vijim nga NVSH është falas për gratë e regjistruara në SSN, me vendqendrim ose me vendbanim në Toskanë, ose në zoterim të STP (I huaj përkohësisht i pranishëm) dhe për studentet deri në moshën 25 vjeçe të regjistruara në Universitetet toskane. Këshillimi kontraktiv dhe fillimi i kontraktivit tashmë është i garantuar nga Repartet dhe nga Klinikat ku kryhet NVSH. Për t'a vazhduar atë, më tej mund të ndiqeni nga Konsultorja.